V E N D I M
Nr.154, datë 3.4.1993

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PERSONAVE QË U MBARON AFATI I PËRKRAHJES SOCIALE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personave të papunë që kanë përfituar përkrahje sociale sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992 dhe ligjin nr.7671, datë 16.2.1993, të cilëve u mbaron afati njëvjeçar i pagesës së përkrahjes sociale, u jepet ndihmë ekonomike në masën 500 lekë në muaj.

2. Personat që u ka mbaruar afati njëvjeçar i përkrahjes sociale para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, marrin ndihmë ekonomike në masën e mësipërme nga data 1.4.1993, në qoftë se familjet e tyre nuk marrin ndihmë në bashki ose komuna.

3. Kjo ndihmë ekonomike do të paguhet pranë zyrës së punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, ku i papuni ka marrë më parë përkrahjen sociale.

4. Për të përfituar ndihmën ekonomike, personi i interesuar duhet të paraqesë në zyrën përkatëse të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim për të përfituar ndihmë, ku përfshihet edhe deklarimi për qënien e tij i papunë.

b) Vërtetim të lëshuar nga organet tatimore, ku të vërtetohet se ai dhe pjestarët e familjes së tij, sipas certifikatës së gjendjes familjare, nuk janë të pajisur me leje të ushtrimit të veprimtarisë private.

c) Vërtetim nga seksioni i financës të bashkisë ose komunës, ku të vërtetohet se familja e personit të interesuar nuk përfiton ndihmë ekonomike.

5. Ndihma ekonomike përfitohet që nga muaji, gjatë të cilit paraqiten dokumentet e mësipërme në zyrën e punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë.

6. Nuk përfitojnë ndihmën e mësipërme personat me banim në fshat, familjet e të cilëve kanë marrë tokë në pronësi ose përdorim, si dhe personat që kanë në përbërje të familjes së tyre pjestarë të pajisur me licencën e ushtrimit të veprimtarisë private.

7. Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë i shtohen 263 milionë lekë në buxhetin e vitit 1993 për ndihmë ekonomike, duke pakësuar buxhetin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë për këtë shumë.

8. Për të përballuar dhënien e kësaj ndihme, Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë i shtohen 100 punonjës në organikë dhe 1 milion lekë fond page.

9. Personat që e përfitojnë këtë ndihmë ekonomike, fitojnë edhe kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, pika I-1 "b".

Ky vendim hyn në fuqi më datën 1.4.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi